

URDHËR
Nr. 40, datë 6.2.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË MJEDISIT, Z. GENT GAZHELI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mjedisit, zëvendësministrit të Mjedisit, z. Gent Gazheli, për ushtrimin e kompetencave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga ndryshimet klimatike, biodiversitetit, zonave të mbrojtura, gjuetisë, menaxhimit të pyjeve, ekonomisë qarkulluese, menaxhimit të mbetjeve, cilësisë së ajrit, monitorimit mjedisor dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Në ushtrim të kompetencave të deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe koordinon proceset që lidhen me zbatimin e programit të qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbetjeve, biodiversitetit, gjuetisë, zonave të mbrojtura, pyjeve, cilësinë e ajrit dhe ekonomisë qarkulluese, përfshirë strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit përkatëse;

b) Ndjek procedurat për hartimin e projektakteve ligjore e nënligjore në përputhje me planin vjetor të projektakteve, të miratuar, si dhe çdo akti tjetër ligjor e nënligjor në fushën e mjedisit;

c) Monitoron dhe koordinon zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare mjedisore dhe nënshkruan aktet përkatëse, përfshirë:

i. Strategjinë e Biodiversitetit;

ii. Dokumentin e politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030;

iii. dokumentin strategjik dhe të planeve kombëtare për cilësinë e ajrit;

ç) Drejton grupe pune për analizimin dhe përmirësimin e programeve dhe projekteve në bashkëpunim me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë;

d) Drejton Këshillin Kombëtar të Faunës;

dh) Drejton punën për nënkapitullin e cilësisë së ajrit dhe nënkapitullin e kimikateve;

e) Trajton dhe monitoron kthimin e përgjigjeve për kërkesat dhe ankesat e institucioneve publike dhe organizmave të tjerë në fushën e mjedisit;

ë) Ndjek dhe nënshkruan aktet e nxjerra në bazë të legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe autorizimet që lëshon ministri, në rast mungese të tij, sipas aktit përkatës të delegimit;

f) Përfaqëson Ministrinë në këshilla, komisione, grupe pune dhe procese ndërinstitutionale brenda dhe jashtë vendit, sipas delegimit dhe fushës së përgjegjësisë;

g) Bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje ndërsektoriale që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike;

gj) Informon periodikisht dhe sipas nevojës Kabinetin e Ministrit për ecurinë e detyrave dhe zbatimin e tyre.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Delegimi i kompetencave sipas këtij urdhri përfundon me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Mjedisit, z. Gent Gazheli dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj